

MIGJENI – Nën flamujt e melankolisë

-Pyetje me shënim-

-shënime-

Kjo poezi i përket ciklit të fundit të “Vargjeve të lira” (Kangët e fundit). Janë poezitë e shkruara dy vitet e fundit të jetës së Migjenit, kur ai duhet ta ketë ndier mjaft pranë këtë fund. Pesimizmi është fryma mbizotëruese në këto poezi (pra edhe te “Flamujt e melankolisë”). Mungesa totale e shpresës gjithashtu.

Flamuri është nga simbolet më të përdorura të traditës poetike shqiptare.

Cila është simbolika e tij tradicionale dhe cila e Migjenit?

Cila është fjala që përforcon gjendjen e melankolisë në vargjet e para të kësaj poezie?

*Në vendin tonë
kudo valojnë
flamujt e një melankolie
të trishtueshme...*

Migjeni në katër vargjet e para nuk mjaftohet vetëm duke dhënë gjendjen si melankolike, nuk mjaftohet duke e etiketuar atë si të trishtueshme... nuk do të lërë asnjë iluzion për shpresë.

*Me cilën fjalë e realizon këtë?
Në vendin tonë
kudo valojnë
flamujt e një melankolie
të trishtueshme...*

Megjithatë përpjekja nuk mungon.

Si është ajo? Pse është e tillë?

Pse fjala “diçka e madhe” shoqërohet me fjalën “xhind”?

*një mund, një përpjekje
për të pjellë diçka të madhe,
për të qitë në dritë një xhind!*

-shënime-

Cila është ironia në këto vargje të poezisë?

*Por, (o ironi)
nga ajo përpjekje lind
vetëm një mi.*

Ç'lloj e qeshure është ajo që dëgjohej në këtë poezi?

*Dhe kështu kjo komedi
na plas dellin e gazit,
nsa prej marazit
pëlcasim.*

A kemi ndonjë fije shprese në tërësinë kësaj poezie apo jo?

*Në prakun e çdo banese
ku ka ndoj shenj jetese
valon nga një flamur
melankolie të trishtueshme.*